



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E TRETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **23.03.2021 (e Martë)**, në zyrën e konferencave ne objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen,

Kryesuesi z.Naim Pira: Më lejoni të ju përshëndes. Diçka në mes takimeve të komitetit, diçka të veçante nuk kemi, vetëm se po vazhdon trendi i të infektuarave me Covid 19, një shtim jashtzakonisht i madh në kohën e fundit. Ne ju shprehim ngushëllime familjeve që kanë humbur më të dashurit e tyre si dhe të sëmurëve shërim të shpejtë, Zyra Ligjore na i ka kthyer disa vendime që i kemi miratuar në seancën e fundit të Kuvendit Komunal të Vitisë, na i ka sugjeruar edhe këtë statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, se na i ka shpallur pjesërisht të ligjshëm për faktin se e diskutonim atë çështjen prokurimit. Na si kuvend nuk kishim pas të drejtë me ndryshuar asgjë, se kish qenë unik për gjithë territorin e Kosovës se dhe dhënien e parkingut dhe autorizimin e kryetarit. Diçka të veçante nuk kemi tjetër për me ju informuar.

znj.Gjylsime Qamili: Unë vetëm desha mi shtua te kryesuesi që i dha informatat për Covidin, vetëm se ka fillua edhe në viti me u bërë testi për Covid 19, është numër i madh i të infektuarave, por gjendja është e menagjueshme.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër për diskutim? Pasi që nuk ka, për këtë seancë kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshme publik.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-1373, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-98, i datës 01.03.2021, paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmase ankandit publik (parkingjet publike)**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-102, të datës 01.03.2021, për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti.**

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-97, i datës 01.03.2021, për autorizimin e Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronave Komunale.

A ka dikush rreth rendit të ditës për të diskutuar ju lutëm? Pasi që nuk ka e qes në miratim rendin e ditës: Konstatohet se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa

A ka dikush rreth pikës së parë ju lutëm? Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë

Është një rregullore që ju ka shtruar edhe debatit publik. Unë po ja kaloj fjalën nënkryetarit rreth kësaj pike të rendit të ditës

Nënkryetari I Komunës Z.Hasan Aliu: Më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, njëherë edhe Jakupit t'i shprehi ngushllime për vdekjen e kushëririt. Kryesuesi e dha këtë propozim rregullore që e keni para jush, ju e keni pas edhe si draft në lexim të parë kur ka qenë, ka kaluar edhe në debatin me qytetar. Unë nuk do të lëshohem me këtë, ju keni pas rast me lexu, për ma shumë nuk kam qashtoj. Për pyetje apo ndonjë sugjerim do ta diskutojmë së bashku.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

znj. Xhylsime Qamili: Unë kam qenë pjesë edhe kur janë mbajtur trajnimet për hartimet e kësaj rregullore, mirëpo do të ndalem te faqe 6, te neni 13, ka qenë edhe ma herët, e kemi diskutuar këtë të kompensimi i mjeteve, nënkupton që mjetet financiare të shfrytëzohen vetëm për nevojat e funksionimit të këshillit lokal, mbahen gjashtë takime deri sa komiteti i marrin për nevoja të veta personale ato mjete. Unë mendoj se duhet me u marr për funksionalizimin e këshillit.

z.Jakup Demiri: Edhe unë e kam hallin te kjo puna e pagesës, për shkak se pjesa ma e madhe e anëtarëve nuk dalin në mbledhje, kurrë gati kuorum nuk ka. Te neni gjashtë, në rast kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbush obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtari dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen më shumicë 50% plus 1 votë të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit me qytetar. Problemi ma i madh është se njerëzit pa pagesë nuk ecin.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Problem është se ligji e njëhë pushtetin lokal dhe pushtetin qendror, por kjo puna e këshillit është që të jetë ma afër qytetarit. Unë kam pyetur edhe jam konsultuar në Shqipëri, ish 50 euro për një takim. Kjo pjesa me ju thanë shko harxhoj me anëtar të këshillit, vetëm qashtoj ju kemi bërë në pandemi duke i thirr me i marr ndihmat me i shpërnda, kështu që u kanë mirë atë mëditje me ja lanë kryekput ati kryetarit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Na duhet me rregulluar këtë çështjen e kompensimit në kuvend, duhet me paraparë, duhet me i marr përvoja të tjera, sepse sa e di unë disa komuna tjera janë duke i paguar.

z.Bekim Azizi: Parimisht na po flasim për përvoja se sa për rregullore. Kjo është rregullore që ta rregullon mënyrën e funksionimit. Te na në Viti kanë filluar ma herët se ne komunat tjera. Ai fshat që e zgjedh një kryetar të mirë, e ka fatin me i ec proceset përpara, ai që nuk i zgjedh i ka telashet e veta, mirëpo na po flasim për dokumentin. Ka qenë edhe ma herët edhe ne diskutim publik ka qenë, unë po kthehem te neni 13, pika 1 dhe pika 4 janë në kundërshtim njëra me tjetrën, sepse përshkruan për punën e tyre, sepse ai në moment që merr pjesë në mbledhje mëditjen që e merr me ja dërgua tjetërkujt, d.m.th. kjo pika katër me të paren është në kundërshtim.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër rreth kësaj pike të rendit të ditës ju lutëm? Pasi që nuk ka, e qes në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Kush është që të shkoj në kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshme publik

Urdhëro drejtoresh, fjala është për ty ju lutëm.

znj.Majlinda Ostrogllava: Na e kemi sjell një propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave. Një sqarim, kjo është gjendja faktike, materialin e keni marr me kohë për pyetje jam në dispozicion të ju përgjigjëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Qysh e di unë, edhe në vitin 72/73 është një marrëveshje edhe nga banoret e fshatit Ramjan, se unë kam qenë edhe tash vonë i kyqur në këtë temë si ndërmjetësues për mos me ardhur deri te një konflikt.

z.Bekim Azizi: Këto rrugë unë i di si te shtëpia ime, sepse dajti i kam aty. Na e dimë se përherë aty ka pas telashe. Unë po të lutëm t'i shikosh mirë letrat, sepse aty është shumë punë e përzier.

z.Ekrem Abazi: Me të thanë të drejtën as nuk e njoh këtë njeri, por unë pajtona plotësisht edhe shumë me vend ka propozuar. Përgjegjësinë na nuk e marrim në bazë ta kësaj, unë mendoj se kjo duhet me kaluar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Vetëm ta sqarojmë këtë, se për këtë rrugë nuk ka ndodh problemi, kjo rrugë aktualisht figuron sipas tyre pronë komunale nëpër oborre të tyre, ndërsa ajo që shfrytëzohet si rrugë, thjeshtë me ja dhanë komunës këtë pronë me marr brenda oborreve, por me i hekë na këto dilema, ndoshta u kanë mirë me kontakti edhe këshillin e fshatit.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Këtu te kompensimi duhet me shiku si po e bajmë, se këtu duhet me ba rrugë të mire që mos të kenë problem masanej banoret e fshatit Ramjan me kaluar në këtë rrugë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po mendoj se kjo nuk është e definuar mirë, për shkak se këtu që e keni qit ju janë diku 3 ari, a duke ditur këtë rrugë mendoj se diçka këtu është gabim. Për atë po mendoj se duhet definuar ma saktë.

z.Jakup Demiri: Ky problem ka filluar me shtëpinë e parë që është ndërtuar aty edhe e kanë nxënë. Unë mendoj se na duhet me i ndihmuar katundit që me zgjidh këtë problem, se ish përfundua ma problemi aty, se na e dimë që aty ka pas edhe vrasje. Unë mendoj pa e marr mendimin e fshatit na nuk guxojmë me krijuar edhe tjera probleme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë e falënderoj drejtoreshën, po duke parë mendimin e juaj për me shty për një mbledhje tjetër, e shpallim zonë me interes edhe e mbyllim këtë problem. Atëherë, a jeni pro që të mbetet me një seancë të radhas kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se kalon propozimi im.

Si pikë tjetër kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-1373, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021

Fjala për ty drejtoresh

znj.Majlinda Ostrogllava: Kjo është pika që në seancën e kaluar nuk ka kaluar ne Kuvend. Kjo është plotësim i listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Nëse nuk ka, unë jam që të shkoj për kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-98, i datës 01.03.2021, paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike)

A jeni që të shfuqizohet edhe kjo pikë? Konstatoj se me vota unanime u shfuqizua kjo pikë.

Si pikë të gjashtë te rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-102, të datës 01.03.2021, për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti

Unë e kam marr vendimin që na i kanë rikthyer, thotë akti i dërguar në ministri për ligjshmërinë e statutit nga Kuvendi Komunal i Vitisë, neni 9, paragrafi 1, pika 1, nuk është e harmanizuar me statutin si formë unike sa i përket departamentit të administratës, sipas formës unike të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë të gjithë kuvendeve komunale. D.m.th për këtë arsye na i kanë kthyer. A jeni që të shkoj për kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe si pikë të fundit kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-97, i datës 01.03.2021, për autorizimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave komunale

A jeni që të shfuqizohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me vota unanime u shfuqizua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
